



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 15-2008
Prishtinë, 10 qershor 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Lutfi Haziri, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Selvije Halimi, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Riza Smaka.

Nga stafi mbështetës i Komisionit në mbledhje ishin të pranishëm: Idriz Tahiri dhe Sulltane Gashi.

Në mbledhje morën pjesë edhe Reshit Gashi - nga NDI, Petrit Hysaj - nga OSCE, Hysni Ismajli - nga Departamenti Ligjor i Kuvendit dhe Fitore Zeneli - nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITES

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 majit 2008;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për ndërmjetësimin;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin e procedurën kontestimore;
5. Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kornizën Kushtetuese;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13 majit 2008

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për ndërmjetësimin

Kryetari – I njoftoi të pranishmit se për ta shqyrtuar këtë projektligj Komisioni e ka caktuar Selvije Halimin raportuese dhe tha se Projektligji nuk ka qenë i vëllimshëm, ishte i hartuar mirë, por shpresoj se edhe anëtarët e tjerë të Komisionit do ta japin kontributin e tyre për shqyrtimin e këtij projektligji me ndonjë sugjerim, rekomandim ose amendament. Pastaj ia dha fjalën Selvije Halimit për t'i prezantuar amendamentet e propozuara.

Selvije Halimi – I falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe tha se me vëmendje e ka shqyrtuar këtë projektligj ku më tepër ka vërejtur disa lëshime që më shumë janë të natyrës teknike sesa lëshime në përmbajtje që e prekin esencën e Projektligjit.

Pas një debati në të cilin morën pjesë, pothuajse, të gjithë anëtarët e Komisionit dhe pas shqyrtimit të propozimeve të raportueses u vendos të propozohen amendamente për këto nene:

Në nenin **1.2**, në rreshtin e tretë, u propozua të hiqet fjala „**posaçërisht**” dhe në rreshtin e gjashtë dhe në të shtatin u bë riformulimi si vijon: „**palët lirisht mund ta disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se**” dhe teksti të vazhdojë si në ligj. U propozua amendamenti i nenit **1.3** që në rreshtin e katërt të hiqet fjala „**një**”. Po ashtu u propozua që në nenin **6.1**, në rreshtin e katërt, të hiqet fjala „**që**”. Në neni **10.3**, pas fjalës **procedurës** shtohet fjala „**së ndërmjetësimit**”. U propozua amendamenti edhe i nenit **17.2**. Fjalja e dytë që fillon në rreshtin e dytë të riformulohet si vijon: „**Kryetari i Komisionit duhet të jetë shërbyes civil dhe emërohet nga Ministria e Drejtësisë**”, kurse në nenin **18.1** u propozua të hiqet fjala „**këshillë**,” dhe të zëvendësohet me fjalën „**komision**”.

Adem Hajdaraj – Bëri vërejtje për gabimet gjuhësore që ishin evidente në amendamentet e propozuara nga raportuesja për këtë projektligj. Ai tha se me rastin e hartimit të amendamenteve në të ardhmen duhet të kihet kujdes që të mos bëhen gabime gjuhësore.

Bahri Hyseni - Theksoi se amendamentet e propozuara do të lekturohen dhe gabimet gjuhësore do të hiqen. Mirëpo shfaqti dyshim për procedimin e Projektligjit. I pyeti anëtarët e Komisionit se a duhet të procedohet ligji në bazë të Kornizës Kushtetuese apo

në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse kur do të procedohet ky projektligj do të jetë në fuqi Kushtetuta.

Të gjithë anëtarët e Komisionit u pajtuan që ky projektligj të procedohet sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ata ishin të mendimit që preambula e këtij projektligji dhe hyrja e tij në fuqi, duhen të jenë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pas debatit, përkitazi me Projektligjin dhe me propozimin e amendamenteve, Komisioni e nxori këtë

P ë r f u n d i m

- 1. Miratohet Projektligji për ndërmjetësimin me amendamentet e propozuara;*
- 2. Projektligji të procedohet për miratim në pajtim me rregullat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;*
- 3. Preambula e Projektligjit dhe dispozitat e hyrjes në fuqi të jenë në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.*

4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin e procedurën kontestimore

Bahri Hyseni – I njoftoi anëtarët e Komisionit për raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin e procedurës kontestimore. Tha se deri tash nuk iu kemi përmbajtur kësaj praktike për t'i shqyrtuar në Komision këto raporte, por tash e tutje do t'i përmbahemi. Ai i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se Projektligji nuk ka implikime buxhetore. Komisioni po ashtu u njoftua se edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka konstatuar se Projektligji nuk i cenon interesat e komuniteteve.

5. Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kornizën Kushtetuese

Komisioni vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës me qëllim që baza juridike e këtyre projektligjeve të procedohet sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

6. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se në mbledhjen e ardhshme do të shqyrtohet Projektligji për noterinë.

U diskutua edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve nga fushëveprimi i këtij komisioni. Bahri Hyseni, lidhur me këtë, tha se duhet të bëhet një kërkesë për t'i vizituar Ministrinë e Drejtësisë, ndonjëherë nga gjykatat e qarkut në Kosovë ose Burgun e Dubravës. Por, më parë duhet të vendosim se cilat raste t'i trajtojmë gjatë vizitës nëpër këto institucione.

Është e nevojshme që Komisioni ta bëjë një vizitë pune në Kuvendin e Shqipërisë për t'u njohur me përvojën e Komisionit të Ligjeve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Prandaj përkitazi me këtë çështje duhet t'i bëhet kërkesë Kryesisë së Kuvendit për ta lejuar realizimin e kësaj vizite.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

Procesverbali u hartua nga stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit

Bahri Hyseni